



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1095/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Zana Këpuska, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër Anëtarëve të Vendvotimit (KVV), Gjakovë për shkak të manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Zana Këpuska, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PDK) dega në Gjakovë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Zana Këpuska, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PDK) dega në Gjakovë, në të cilën theksohet se votat e saj nuk janë numëruar dhe përshkruar në formularin e rezultateve të kandidatëve për asamble komunale në Gjakovë, dhe se ky përshkrim jo i saktë është bërë nga ana e anëtarëve të vendotimeve në QV 0203c/4 dhe 0203c/1 në ShF “Mazllom Këpuska” ku në bazë të dëshmiave verbale të një anëtari të Vendvotimit nga subjekti politik AKR, Afërdita Gurkuqi me ka informuar se në atë VV i ka numëruar 10 vota kurse në formular i janë përshkruar 3 vota, po ashtu në ankesë theksohet se në rezultatet preliminare nga anëtari i KKZ votat për kandidatë sipas QV thekson se ka qenë e renditur e dyta me 173 vota kurse kandidatja Fllloza Rexhepi me 157 vota, kurse në listën përfundimtare të publikuar nga KQZ kanë ndryshuar rezultatet ku Fllloza Rexhepi ka 180 vota ndërsa Zana Këpuska 175 vota thekson parashtrësia e ankesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtrësia e ankesës Zana Këpuska kandidate për anëtarë të kuvendit komunal, në Gjakovë nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me atë për të cilën pretendon se kandidatja tjetër ka numër më të madh të votave, dhe se pretendimet e palës ankuese janë supozime dhe nuk janë

të mbështetura në prova dhe fakte bindëse, prandaj PZAP-i, në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1095/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.